



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:157882
Datë: 02.02.2024
Numri i dokumentit: 05278418

AA.nr.32/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësi Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, kundër të paditurës Komuna Klinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e palës se interesuar W... L.L.C., të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1962/2020, të datës 04.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Miratohet si e bazuar ankesa e palës se interesuar W... L.L.C, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1962/2020, i datës 04.12.2023, **anulohet**, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1962/2020, të datës 04.12.2023 është hedhë poshtë kërkesa e datës 07.09.2023, për rishikim të aktvendimit A.nr.1962/2020 dhe shtyrje të ekzekutimit të vendimit datë 05.03.2020, parashtruar nga W... L.L.C.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i palës se interesuar, R.M dhe A.Q, për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës dhe parashtrësës së datës 18.01.2024. Duke theksuar në mes tjerash se Gjykata e Apelit e Kosovës me datën 23.11.2023 ka nxjerrë aktvendimin AA.nr.843/2023 më të cilën e ka aprovuar të bazuar ankesën e palës së interesuar, ka prishë lëndën A.nr.1962/2020 dhe të njëjtën ja ka kthye gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, duke theksuar ndër të tjera se palës së interesit më këto veprime (moslejimin për përfshirje dhe mos dhënien e mundësisë që të jetë palë në shqyrtimin e kësaj çështje) i është cenuar interesi juridik. Pavarësisht të gjeturave të

Gjykatës së Apelit sa i përket konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes të dispozitave të LKA, dhe obligimit që si gjykate e shkallës së parë duhet të ndjeje udhëzimet e gjykatës së shkallës së dytë, dukë potencuar faktin se pala e interesit i ka tri pëlqime të lëshuara të cilat ndikohen nga vendimi kontestues i të paditurës. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative me datë 04.12.2023, pa dhënë asnjë arsye në aspektin juridik dhe faktike, serish e ka hedhe poshtë kërkesën e datës 07.09.2023 për rishikim të aktvendimit A.nr.1962/2020 me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të datës 05.03.2020, duke e mohuar ekzistimin e interesit juridik për palën e interesit. Pala e interesit me datën 22.12.2023 ka ushtruar ankesë ndaj aktvendimit A.nr.1962/2020 të datës 04.12.2023 me kërkesë që të aprovohet në tërësi e bazuar ankesa e palës se interesit ndërsa aktvendimi të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje dhe për arsye të dhëna në aneks të urdhërohet që çështjen ta shqyrtoje dhe të vendose një gjyqtar/e tjetër.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore në ankesë dhe në parashtrësën për plotësimin e ankesës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të LKA-së, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin A.nr.1962/2020 të datës 10.09.2023 e ka hedhe poshtë kërkesën e datës 07.09.2023, për rishikim të aktvendimit A.nr.1962/2020 për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të datës 05.03.2020, të parashtruar nga W... L.L.C.

Kundër këtij aktvendimi pala e interesuar W... L.L.C., ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, ndërsa Gjykata e Apelit me vendimin AA.nr.843/2023 të dt.23.11.2023 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës se interesuar, W... L.L.C, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1962/2020, të datës 10.09.2023 e ka prishur dhe çështjen e ka kthyer te gjykata e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, me arsyet si në aktvendim.

Ndërsa, gjykata e shkallës së parë me rastin e rivendosjes së kësaj çështje me aktvendimin A.nr.1962/2020 të dt.04.12.2023, nuk i ka përfillur vërejtjet e Gjykatës së Apelit, ka vepruar njëjtë si në Aktvendimin A.nr.1962/2020 të dt. 10.09.2023.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo çështje e gjendjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që i njëjti është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 lidhur me nenin 199 të LPK-së të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së.

Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, si të ligjshëm për shkak se gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që të zbatojë udhëzimet e Gjykatës së Apelit të dhëna me aktvendimin AA.nr.843/2023 të dt.23.11.2023, me të cilin është prishur aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë A.nr.1962/2020 i dt.10.09.2023 dhe çështja ishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje, me udhëzime se cilat veprime duhet ti ndërmar gjykata e shkallës së parë në riprocedurë. Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të shkresave të lëndës nga Gjykata e Apelit nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, por ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar me të cilin e ka hedhur

poshtë kërkesën e datës 07.09.2023 për rishikim të aktvendimit A.nr1962/2020 dhe për shtyrje të egzekutimit të vendimit të datës 05.03.2020 të parashtruar nga W... L.L.C.

Sipas dispozitës së nenit 199 të LPK-së përcaktohet se “Gjykata e çështjes ka për detyrë që menjëherë pasi t’i arrijë aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, të caktojë seancën përgatitore apo seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes e cila duhet të mbahet më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditor pas arritjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, si dhe t’i kryejë të gjitha veprimet procedurale dhe t’i shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj.” Ky është një përcaktim ligjor i cili duhet të zbatohet me korrektësi nga gjykata e shkallës së parë, sepse përmes udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë janë përcaktuar veprimet që duhet të ndërmerren gjykata e shkallës së parë në funksion të zhvillimit të procedurës në mënyrë ligjore, në funksion të konstatimit të fakteve për çështjen, si dhe në funksion të nxjerrjes së një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm, pa cënuar pavarësinë e gjykatës së shkallës së parë mbi vendimmarrjen.

Duke qenë se Gjykata e Apelit me aktvendimin AA.nr.843/2023 të dt.23.11.2023 kishte udhëzuar gjykatën e shkallës së parë për veprimet të cilat duhet të ndërmerren në riprocedurë e të cilat veprime nuk janë ndërmarrë, duke pasur parasysh pretendimet ankimore në ankesën e palës së interesuar për ndërhyrje në procedurë, se kanë interes juridik me qenë palë e interesuar, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar së aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë, ngase përmban shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 21, 37 dhe 39 dhe 55 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Ngase me nenit 21 të LKA-së, përcaktohet se “Pozitën e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi të cilit anulimi i aktit administrativ të kontestuar do ti sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë”. Në rastin konkret ky kusht është plotësuar. Ngase pala e interesuar, W... L.L.C nuk ka qenë të përfshirë dhe nuk iu ka dhënë mundësia që të jetë palë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, të cilat bëjnë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura që ky aktvendim të mos mund të ekzaminohet, dhe si i tillë është jo i plotë për faktin se nuk janë dhënë arsye përkitazi me faktet vendimtare. Sepse në këtë çështje juridike, nuk ka qenë e përfshirë pala e interesuar, me çka ka shkaktuar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës të theksuar më lart kjo për faktin se në këtë procedurë, përkatësisht me vendimin e të paditurës, Komuna e Klinës, me 01nr.06-8940/2020, të datës;05.03.2020, të kontestuar nga paditësja, në pikën I të tij është vendosur, “Anulohen i të gjitha pëlqimet dhe dokumenteve tjera urbanistike që janë dhënë lidhur me gurorët për furnizim me lëndë të parë për fabrikat e çimentos.” Kurse nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës palës së interesuar i janë lëshuar tre pëlqime të tilla me nr.06 nr.350-51511/19, nr.06 nr.350-51509/19, nr.06 nr.350-51503/19, të datës;27.12.2019. Gjykata e shkallës së parë, siç rezulton nga shkresat e lëndës dhe arsyetimi i aktvendimit nuk ka ftuar palët e interesuara për shqyrtimin e kontestit edhe pse shihet qartë interesi i tyre për pjesëmarrje në kontest, pasi ka të drejtë në pjesëmarrje për të mbrojtur interesat të cilat i janë përcaktuar me ligj. Pala e interesuar gjithashtu ka të drejtë të shfrytëzimit të gjitha mjeteve juridike në konfliktin administrativ. Prandaj, nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë nuk i ka njohur këto të drejta palës së interesuar. Me vet faktin se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë për këtë, dhe as arsyetim të plotë se për çfarë arsye nuk iu kanë njohur kjo e drejtë dhe nuk ju është dhënë mundësia që të jenë palë në procedurë. Prandaj edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht. Për këto arsye, në rigjykim, Gjykata e shkallës së parë duhet të mënjanoj të metat e lartcekura, të kujdeset që çështja kontestuese të shqyrtohet në tërësi, duke ia lejuar dhe njohur të drejtën palës së interesuar si palë në procedurë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, pastaj pas shqyrtimit të prezumimeve proceduralë lidhur me padinë dhe çështjeve tjera të vendosë çështjen në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Kolegji i kësaj gjykate duke vlerësuar ankesën e paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, A.nr.1962/2020 të datës 04.12.2023 si dhe shkresave të tjera të lëndës

vlerëson se, aktvendimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave të lartcekura të LKA-së edhe shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n), neni 182 par.1, neni 8 dhe 160 par.4 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktet administrative. Andaj, aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është anuluar dhe lënda kthehet në rigjykim nga gjyqtari i njëjte meqë nuk është aprovuar propozimi për të vendosur një gjyqtarë tjetër sepse në bazë të nenit 198 par.3 të LPK-së parashihet se gjykata e shkallës së dytë mund të urdhëroj që rishikimi i çështjes të bëhet nga gjyqtari tjetër pra nuk është obligatorë kjo dispozite ligjore për ndërrimin e gjyqtarit.

Prandaj, meqë gjykata e shkallës së parë nuk ka respektuar udhëzimet e Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në ri procedure, duhet ti eliminojë shkeljet e sipër theksuara dhe të veprojë në përputhje me udhëzimet që ka dhënë Gjykata e Apelit, në aktvendimin AA.nr.843/2023 të dt.23.11.2023, në atë mënyrë që në bazë të provave të paraqitura të administruara dhe të vlerësuara të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, i cili do të përmbajë arsyetimin lidhur me vendimin e marrë dhe sqarimin në hollësi se cilat nga pretendimet e palës së interesuar janë të bazuara dhe në cilat prova e të cilat e bëjnë të ditur shkaktimin e dëmit dhe plotësimin e kushteve ligjore konform nenit përkatës.

Nga sa u tha më lartë në bazë të nenit 49 të LKA, lidhur me nenin 209 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.32/2024, me datë 29.01.2024

Kryetar i kolegjit,
Ramiz Kuqi